



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQERIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A.

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje reagentësh, paisje laboratorit dhe impjanti”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Reagentë kimikë 33696300-8**

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **19.800.000.02 (Nentembedhjetë milion e teteqind mijë presje zero dy) lekë pa tvsh.**

Vlera e fondit limit në monedhen nderkombetare Euro sipas kursit të Bankes së Shqipërisë është 207.656 (dyqind e shtatë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë) Euro

** Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 21.05.2026 është 95.35 Lekë/Euro.*

Argumentimi: Perlllogaritja e vlerës së fondit limit është bërë referuar Nenit 35 të ligjit nr.162/2020, si dhe nenit nr.13 dhe nenit nr.76 të VKM 285 datë 19.05.2021, të ndryshuar

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Bazuar në nenin 39 të LPP-së dhe në nenin 42 të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor vendos të mos e ndajë procedurën e prokurimit në lote për arsye sepse kjo garanton dhe siguron efektivitet në lidhje me shpejtësinë e furnizimit me mallra.

Me qëllim garantimin e furnizimit brenda afatit kohor të përcaktuara, procedura jo e ndare në lote do të garantonte sigurinë e furnizimit sipas kushteve të përcaktuara dhe brenda afatit të kërkuar duke sjellë stabilitet në menaxhimin e kontratës dhe të nevojave të AK.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, autoriteti/enti kontraktor SHRUKD sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4

b. Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: :

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/ kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023,2024,2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% i fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. e ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 , pika 1 , pika 2 , si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2026.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2026, sipas të dhënave të QKB-së.

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kritereve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 9, bazuar në

nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, AK gjykon se kriteri i vendosur lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2026 sipas kërkesave prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a). për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruara ne organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara,

b). për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes dhe të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

c)Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës ,është mbi kufirin e lartë monetar .Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke opatur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet koitl aktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqes katalogët origjinale të markuar për artikujt e ofertuar. Katalogjet /Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë e mallrave objekt prokurimi dhe të jenë të përkthyer dhe të noterizuar.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: fotografitë apo katalogjet teknike. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që me paraqitjen e katalogut të bëhet i mundur një vlerësim sa më korrekt dhe të saktë të mallrave që do të prokurohen, që të jenë në përputhje me specifikimet e kërkuara, për të përmbushur kontratën.

Autoriteti kontraktor synon verifikim e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë ofertues me ato të kërkuara në dokumentet standarde të tenderit.

“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: fotografitë apo katalogët teknike”

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të deklarojë se për Artikujt Nr. 1, 2, 3 dhe 4 te Shtojca 6 duhet të mbajë garanci 1 vit kalendarik nga koha e dorëzimit të pajisjes. Në rast difekti të këtij artikulli Operatorit Ekonomik duhet ti rregullojë falas. Tek difektet e këtij artikulli nuk përfshihen goditjet me forcë ose thyerjet. Mbasi mbaron periudha 1 (një) vjeçare e garancisë, në rast se pajisja pëson

difekt, Operatori Ekonomik duhet ti përgjigjet Autoritetit Kontraktor për riparimin e pajisjes duke përfshirë çmimin e pjesës me difekt. **Për këtë kriter Operatori Ekonomik duhet të paraqesi vetëdeklarim.**

Argumenti: Ky kriter kërkohet për të pasur garanci 1 (një) vjeçare për pajisjet e kërkuar dhe mbas mbarimit të periudhës 1 (një) vjeçare Autoriteti Kontraktor të ketë të drejtën ligjore ti drejtohet Operatorit Ekonomik për rregullimin e pajisjes.

2.3.4 Në lidhje me artikullin Nr. 4 te Shtojca 6, Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura Durrës vë në dispozicion vetëm pikën e lidhjes elektrike të pajisjes. Gjithahtu kërkohet që pajisja të jetë e kalibruar nga fabrika. Operatori Ekonomik duhet të deklarojë me anë të një vetdeklarimi që merr përsipër instalimin e pajisjes, vënien në punë dhe trajnimin e stafit të laboratorit për përdorim.

Argumenti: Ky kriter kërkohet për arsyen se Impianti nuk ka staf të kualifikuar për instalimin dhe vënien në punë të kësaj pajisjeje. Pjesa e kalibrimit kërkohet për shkak të procedurave të akreditimit të laboratorit.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, të punësuar me kohë të plotë si më poshtë:

a) **1 (nje) kimist**, me eksperiencë në analizat e ujërave të pijshëm dhe atyre të ndotur.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Cv,
- Diplomën përkatëse dhe
- Kontratë punësimi të vlefshme.

Argumentim: **Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 gërma b) dhe c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë specialiste me njohuri të nevojshme për te furnizuar produktet e nevojshme dhe për te trajnuar përdoruesit për te garantuar matje të sakta nepermjet sistemit të kontrollit të cilësise të pajisjeve matese me kitet që do furnizohen.**

Specialisti i mësipërm duhet të kryejnë trajnimet e stafit të laboratoreve për metodat e kontrollit të cilësisë së analizave të ujit të pijshëm dhe atyre të ndotur.

Shenim-Kriteri mbi dokumentacionin e stafit i cili përfshihet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, referuar nenit 26, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ‘Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, operatori ekonomi i kualifikuar i pari duhet të paraqesi dokumentacionin provues të parashtruar në pikat ‘a’, ‘b’, ‘d’, ‘dh’, ‘e’, ‘h’, ‘i’, ‘j’ të pikës 2 të këtij neni si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumenta duhet të paraqiten origjinale ose kopje të njësuar me origjinalin.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik ofruar që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë çertifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që janë në përputhje me objektin e kontratës, çertifikatat kërkohen të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. si më poshtë:

1. ISO 9001:2015 ose ekuivalente në fushën e menaxhimit të cilësisë
2. ISO 14001:2015 ose ekuivalente në fushën e menaxhimit të mjedisit,

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatat ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit)

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nënën të 36 dhe 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” **Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor** dhe nënëve 40, pika 8, dhe 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mundësitë për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.4.2 Kitet të plotësojnë standardin për analizat e ujërave të ndotura të impianteve të trajtimit.

Per pikën e mësipërme operatori ekonomik duhet të paraqesi vetdeklarim.

Argumentim: **Kitet duhet të jenë konform parametrave të përcaktuar në ligjin 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, i ligjit 8102 “ Për largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura” i amenduar me ligjet Nr 9352, Nr 9584 dhe Nr 9915 por edhe i VKM 177, datë 31.03.2005 “ Normat e lejuara lidhur me çështjet e shkarkimit të ujërave dhe kriteret zonale të organeve marrëse”.**

Kërkesa e mësipërme është bazuar nënën 36, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

2.4.3 Kitet të furnizohen me manualët e përdorimit në anglishte dhe Shqip

Argumentim: **Kërkesa e mësipërme është bazuar nënën 24 të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” në të cilën përcaktohet se ‘Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe.’**

Në rast se manualët e përdorimit nga prodhuesi vijnë në gjuhën angleze ato duhet patjetër të përkthehen në gjuhën shqipe.

2.4.4 Operatori Ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër transportin e artikujve në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor dhe afatet e lëvrimit. Për këtë kriter Operatori Ekonomik duhet të paraqesi vetdeklarim.

Argumenti: Ky kriter kërkohet për Operatorin Ekonomik që të marrë përsipër sjelljen e artikujve të kërkuar pranë Laboratorit të Ujërave të pijshëm dhe Laboratorit të Impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura Durrës.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performancë, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Specifikimet teknike:

Nr.	Emërtimi i artikullit	Specifikimet teknike	Njësia	Sasia
1	Spektrofotometër	photoLab 7600 UV-VIS. Spektrofotometër me teknologjinë e rrezeve referente. Diapazoni i gjatësisë valore 190 - 1100 nm. Burimi i dritës duhet të jetë llampë blic ksenoni ose ekuivalente. Vendin ku futen provëzat e rrumbullakta duhet të jenë me diametër të jashtëm 16 mm, diametër të brendshëm 13.6 mm dhe me pjesën fundore të sheshtë. Vendi ku futen	copë	1

		provëzat drejtkëndore duhet ta kenë gjatësinë e rrugës 10 mm, 20 mm dhe 50 mm dhe thellësinë maksimale 12.6 mm. Furnizimi me energji: 100 – 230 V, 50 – 60 Hz. Klasa e mbrojtjes, minimum IP31. Çertifikuar nga Bashkimi European. Ose ekuivalent.		
2	Sistem matës BOD	OxiTop IS 6. 6 koka matëse. 6 shishe mostre PF600. 6 tapa gome. 6 kapsula nxitëse. Shkopin për heqjen e kapsulave nxitëse. Ose pajisje me ekran dixhital për leximin e drejtpërdrejtë të regjistrimit automatik të të dhënave. Platformën nxitëse SI 6. Pajisja duhet të lejojë matjen e minimumit 6 mostrave njëkohësisht.	copë	3
3	Distilator	Water Still 2004. Rezervuari i magazinimit 8 litra ujë të distiluar. Kapaciteti i distilimit 4 litra/orë. Elemente ftohëse dhe ngrohëse të bëra prej çeliku inox. Termostat që shkëput ngrohësin kur nuk ka furnizim me ujë. Funksion monitorimi që shkëput distiluesin kur rezervuari është plotësisht i mbushur dhe rifillon kur zbrazet. Model tavoline me pajisje për ta varur në mur.	copë	1
4	Kampionatorë automatik për mostra uji	Liquistation CSF48. Pompë peristaltike ose vakumi për marrjen e mostrave. Ekran kontrollues. Shishe mostrash PE ose qelqi për ruajtjen e mostrës. Rregullator temperature në dhomën e marrjes së mostrave për ruajtjen e sigurtë të mostrës 4 °C. Linjë thithëse me kokë thithëse. Sistemi i marrjes së mostrës duhet të ketë shkallën e rrjedhjes, marrjen e mostrave proporcionale në kohë, marrjen e mostrave proporcionale në vëllim, Tubi i thithjes duhet të ketë gjatësi minimale	copë	2

		prej 10 metra. Çertifikuar nga Bashkimi European. Ose ekuivalent.		
5	Pajisje për marrjen e mostrave	Teleskopik. Gjatësia 2 - 4.5 metra me suport të përshtatshëm për shishe mostrimi me vëllim 250 - 1000 mililitra	copë	1
6	Sterilizues për sistemin inoks të filtrimit mikrobiologjik	Set i kompletuar me pishtar gazi portativ me pistoletë flakëdhënëse	copë	2
7	Kite testuese COD	C 3/25. Teste për matjen e kërkesës kimike për oksigjen. Diapazoni 10 - 150 mg/l. I matshëm tek photoLab 7600 UV - VIS. Kite me 25 teste	kite	40
8	Kite testuese COD	C 4/25. Teste për matjen e kërkesës kimike për oksigjen. Diapazoni 25 - 1500 mg/l. I matshëm tek photoLab 7600 UV - VIS. Kite me 25 teste	kite	60
9	Kite testuese Azoti total	Teste për matjen e azotit total. Diapazoni 0.5 - 15.0 mg/l. I matshëm tek photoLab 7600 UV - VIS. Kite me 25 teste	kite	40
10	Kite testuese Azoti total	Teste për matjen e azotit total. Diapazoni 10 - 150 mg/l. I matshëm tek photoLab 7600 UV - VIS. Kite me 25 teste	kite	60
11	Kite testuese Fosfori total	P 6/25. Teste për matjen e fosforit total. Diapazoni 0.05 - 5.00 mg/l. I matshëm tek photoLab 7600 UV - VIS. Kite me 25 teste	kite	60
12	Kite testuese Fosfori total	P 7/25. Teste për matjen e fosforit total. Diapazoni 0.5 - 25.0 mg/l. I matshëm tek photoLab 7600 UV - VIS. Kite me 25 teste	kite	40
13	Kite testuese Nitrite	NO ₂ - N. Teste për matjen e nitriteve. Diapazoni 0.010 - 0.700 mg/l. I matshëm tek photoLab 7600 UV - VIS. Kite me 25 teste	kite	80
14	Kite testuese Nitrate	NO ₃ - N. Teste për matjen e nitrateve. Diapazoni 0.5 - 25.0 mg/l. I matshëm	kite	80

		tek photoLab 7600 UV - VIS. Kite me 25 teste		
15	Kite testuese Amoniaku	NH ₄ - N. Teste për matjen e amoniakut. Diapazoni 4.0 - 80.0 mg/l. I matshëm tek photoLab 7600 UV - VIS. Kite me 25 teste	kite	40
16	Kite testuese Amoniaku	NH ₄ - N. Teste për matjen e amoniakut. Diapazoni 0.010 - 2.000 mg/l. I matshëm tek photoLab 7600 UV - VIS. Kite me 25 teste	kite	60
17	Kite testuese Ortofosfate	PO ₄ - P. Teste për matjen e ortofosfate. Diapazoni 0.05 - 5.00 mg/l. I matshëm tek photoLab 7600 UV - VIS. Kite me 25 teste	Kite	60
18	Kite testuese Ortofosfate	PO ₄ - P. Teste për matjen e ortofosfate. Diapazoni 0.5 - 25.0 mg/l. I matshëm tek photoLab 7600 UV - VIS. Kite me 25 teste	kite	80
19	Frenues nitrifikimi	Shishe 50 ml	shishe	50
20	Hidroksid natriumi	Peleta për përcaktimin e BOD me OxTop. Kuti 50 gram.	kuti	50
21	Solucion për duart	Higjenik, Antibakterial. Shishe 500 ml	shishe	50
22	Kavanoz qelqi për mostra	Kavanoz me tape, masa 500 ml	copë	20
23	Maska mbrojtëse	Maska 1 përdorimshe	copë	400
24	Doreza mbrojtëse	Doreza nitrili për përdorim laboratorik, pa pudër. 1 përdorimshe. Madhësia M + L	copë	2500
25	Fitra për TSS	Fitra mikrofibër xhami 45 mm për matjen e totalit të lëndës së ngurtë pezull	copë	2000
26	Fitra për TSS	Fitra mikrofibër xhami 90 mm për matjen e totalit të lëndës së ngurtë pezull. Filtra të palosshme.	copë	100
27	Erlenmeyer	Vakumi, me mbrojtëse poshtë, madhësia 1000 ml	copë	2

28	Hink	Qelqi. Madhësia 50 - 100 mm.	copë	2
29	Alkol etilik	Për dizinfektim. 96 %. Shishe 1 litër	shishe	50
30	Mashë	Mashë metalike për laborator	copë	1
31	Pinceta	Inoks. Me majë të sheshtë	copë	2
32	Bateri	Për kokat e shisheve të BOD ₅ . GP Lithium CR 2450 3V.	copë	30
33	Bateri	Për kokat e shisheve të BOD ₅ . GP Lithium CR 2430 3V.	copë	50
34	Mbajtëse epruvetash	Materiali metalik, minimumi 20 vende, për epruveta 10 ml	copë	4
35	Stativ pipetash	Forma rrethore. Vendosje horizontale për pipetat. Minimalja 20 vende. E përshtatshme për pipeta nga 1 ml deri në 10 ml	copë	3
36	Kontrollues manual i pipetës	Ngjyrë jeshile. I përshtatshëm për pipeta 10 ml	copë	2
37	Kontrollues manual i pipetës	Ngjyrë blu. I përshtatshëm për pipeta 2 ml	copë	3
38	Solucion	Acid acetik 10% për pastrimin e pajisjeve. Shishe 1 liter	shishe	4
39	Solucion	Acid nitrik 10% për pastrimin e pajisjeve. Shishe 1 liter	shishe	4
40	Bufer kalibrimi	Solucion Buffer Standard për pH 10. Shishe 1 litër	shishe	3
41	Bufer kalibrimi	Solucion Buffer Standard për pH 4. Shishe 1 litër	shishe	3
42	Bufer kalibrimi	Solucion Buffer Standard për pH 7. Shishe 1 litër	shishe	3
43	Pipeta vëllimore	Masa 1 ml, material qelqi	copë	20
44	Pipeta vëllimore	Masa 2 ml, material qelqi	copë	20
45	Pipeta vëllimore	Masa 5 ml, material qelqi	copë	20
46	Pipeta vëllimore	Masa 10 ml, material qelqi	copë	15

47	Pjata Petri	Terrene për matjen e koliformit total së bashku me filtrat	copë	4000
48	Solucion	Solucion standard për sondën që mat konduktivitetin, lëndën totale të ngurtë të tretur dhe kripshmërinë. Shishe 500 ml	shishe	4
49	Beker	Gotë qelqi. Madhësia 1000 ml	copë	8
50	Beker	Gotë qelqi. Madhësia 500 ml	copë	10
51	Beker	Gotë qelqi. Madhësia 250 ml	copë	10
52	Beker	Gotë qelqi. Madhësia 100 ml	copë	10
53	Set furçash	Për pastrimin e provëzave, tel i harkuar i galvanizuar dhe fiçe të forta, madhësi të vogël, të mesme dhe të madhe	copë	2
54	Stativ	Për tharje epruvetash, materiali plastik, me 12 vrima dhe vend për tharje	copë	4
55	Bufer amoniaku	pH ~ 10, shishe 1 litër	shishe	3
56	CaCO ₃	Pluhur grade laboratorike me pastërti >99%, paketim 1 kilogram	copë	2
57	Acidit Klorhidrik	HCl 37%, shishe 1 litër	shishe	3
58	Acid Sulfurik	H ₂ SO ₄ 98%, shishe 1 litër	shishe	3
59	Acid Oksalik	C ₂ H ₂ O ₄ grade laboratorike me pastërti >99%, paketim 1 kilogram	copë	3
60	EDTA kristal	Ethylenediaminetetraacetic acid, paketim 1 kilogram	copë	2
61	Eriochrome BLACK-T Indikator	Shishe 100 gram	shishe	3
62	Tretësirë Standarte KMnO ₄	Potassium Permanganate 0.01N, shishe 1 litër	shishe	4
63	Solucion	Buffer për Turb 750 IR 10.0 NTU/FNU, shishe 125 ml	shishe	1
64	Solucion	Buffer për Turb 750 IR 1000 NTU/FNU, shishe 125 ml	shishe	1

65	Solucion	Buffer për Turb 750 IR 0.02 NTU/FNU, shishe 125 ml	shishe	1
66	Përparëse laboratorit	Ngjyra e bardhë, 4 me madhësi M, 3 me madhësi L, 2 me madhësi XL dhe 1 me madhësi 2XL	copë	10
67	Bateri 1.5 V	Për pajisje e laboratorit, Madhësia standarte AA.	copë	60
68	Bateri	Bateri Li-ion e rikarikueshme, 3.7V 11.84Wh	copë	2
69	Shishe	Për mostrim, materiali qelq, madhësia 1 litër	shishe	10
70	Set me gur peshash	Në kuti plastike, përmban gur peshash me madhësi të ndryshme 1 – 50 gram, (1, 2, 2, 5, 10, 20, 50, 100, 200, 200, 500) gram. Gjithsej 1110 gram.	copë	1
71	Kyvetë	Materiali qelq, madhësia 10 mm, i përshtatshëm për Spectroquant Prove 300+	copë	3
72	Kyvetë	Materiali qelq, madhësia 10 mm, i përshtatshëm për fotometer PF3	copë	3
73	Pipeta	Automatike, madhësia 1-5 ml	copë	2
74	Maja	Për pipeta automatike me madhësi 1-5 ml	copë	200
75	Pipeta	Automatike, madhësia 0.1-1 ml	copë	2
76	Maja	Për pipeta automatike me madhësi 0.1-1 ml	copë	200
77	Epruveta	Me kapak, madhësia 10 ml	copë	25
78	Epruveta	Pa kapak, madhësia 10 ml	copë	25
79	Balona tarimi	Materiali qelq, me tap të bardhë. madhësia 500 ml.	copë	2
80	Balona tarimi	Materiali qelq, me tap të bardhë. madhësia 250 ml.	copë	2
81	Balona tarimi	Materiali qelq, me tap të bardhë. madhësia 100 ml.	copë	10

82	Balona tarimi	Materiali qelq, me tap të bardhë. madhësia 1000 ml.	copë	4
83	Erlenmeyer	Materiali qelq, madhësia 250 ml	copë	3
84	Erlenmeyer	Materiali qelq, madhësia 100 ml	copë	3
85	Erlenmeyer	Vakumi, me mbrojtëse poshtë, madhësia 500 ml	copë	2
86	Cilindër	Materiali qelq, volumetrik klasi A, 5 ml i shkallëzuar	copë	3
87	Cilindër	Materiali qelq, volumetrik klasi A, 10 ml i shkallëzuar	copë	3
88	Cilindër	Materiali qelq, volumetrik klasi A, 25 ml i shkallëzuar	copë	2
89	Cilindër	Materiali qelq, volumetrik klasi A, 50 ml i shkallëzuar	copë	3
90	Pinceta Laboratorike	Materiali çelik inox, anët me brinjë, majat e drejta dhe të topitura, madhësia 125 mm)	copë	2
91	Tableta klori	DPD №1 HANNA	teste	4000
92	Tableta klori	DPD №4 HANNA	teste	400
93	Tretësirë KCl	Solucion Elektrolit 3 mol/l KCl, madhësia 50 ml	shishe	3
94	Adaptor	Adaptor zëvendësues, tipi A, për Hach DR 3900	copë	1
95	Sondë	Për matjen e oksigjenit, DO, për multiparameter 3620 IDS	copë	1
96	Sondë	Për matjen e pH, për multiparameter 3620 IDS	copë	1
97	Byreta titrimi	Madhësia 25 ml	copë	4
98	Byreta titrimi	Madhësia 50 ml	copë	2
99	Stativ	Për mbajtjen e byretave	copë	2
100	Shufer	Materiali qelq, për përzierje me të dyja majat e mbyllura	copë	3

101	Shufer	Magnetike, për përzierje, madhësi të madhe	copë	2
102	Shufer	Magnetike, për përzierje, madhësi të vogla	copë	3
103	Shufer PTFE	Për nxjerrjen e shufrave magnetike	copë	1
104	Nitrite	NO ₂ - N. Teste për matjen e nitriteve. Diapazoni 0.002 – 1.00 mg/l. I përshtatshëm për Spectroquant Prove 300+. Kite me 1000 teste	kite	3
105	Nitrite	NO ₂ - N. Teste për matjen e nitriteve. Diapazoni 0.015 – 0.600 mg/l. I matshëm tek Hach DR 3900. Kite me 25 teste	kite	22
106	Nitrate	NO ₃ - N. Teste për matjen e nitrateve. Diapazoni 0.2 - 20.0 mg/l. I përshtatshëm për Spectroquant Prove 300+. Kite me 100 teste	kite	15
107	Nitrate	NO ₃ - N. Teste për matjen e nitrateve. Diapazoni 0.3 - 22.0 mg/l. I përshtatshëm për Nanocolor VIS II. Kite me 20 teste	kite	20
108	Nitrate	NO ₃ – N. Teste për matjen e nitrateve. Diapazoni 0.23 - 13.5 mg/l. I matshëm tek Hach DR 3900. Kite me 25 teste	kite	22
109	Amoniaku	NH ₄ – N. Diapazoni 0.010 - 3.000 mg/l. I përshtatshëm për Spectroquant Prove 300+. Kite me 500 teste	kite	10
110	Amoniaku	NH ₄ – N. Diapazoni 0.015 - 2.000 mg/l. I matshëm tek Hach DR 3900. Kite me 25 teste	kite	22
111	Hekuri	Kite për matjen e hekurit. Diapazoni 0.0025 – 5.00 mg/l. I përshtatshëm për Spectroquant Prove 300+. Kite me 250 teste	kite	10
112	Kalciumi	Kite për matjen e kalciumit. Diapazoni 10 – 250 mg/l. I përshtatshëm për Spectroquant Prove 300+. Kite me 25 teste	kite	10
113	Alumini	Kite për matjen e aluminit. Diapazoni 0.02 – 1.20 mg/l. I përshtatshëm për Spectroquant Prove 300+. Kite me 350 teste	kite	10

114	Fortësia e ujit	Kite për matjen e fortësisë së ujit. Diapazoni 1 – 20 °dH. I matshëm tek Hach DR 3900. Kite me 25 teste	kite	22
115	DR/Check	Absorbance standard, kit i matshëm tek Hach DR 3900	kite	1
116	Provëza zero	Zero cell, i përshtatshëm për Spectroquant Prove 300+	copë	1
117	Fortësia e ujit	Kite për matjen e fortësisë së ujit me metode titrimetrike, i përshtatshëm për Spectroquant Prove 300+. Kite me 300 teste	kite	10
118	Fortësia e ujit	Kite për matje e fortësisë së ujit, i përshtatshëm për Nanocolor Vis II. Kite me 20 teste	kite	5
119	Ortofosfatet/fosfori total	Kite testuese Ortofosfate/fosfor total. Diapazoni 0.05-0.5 mg/l, i përshtatshëm për Nanocolor VIS II. Kite me 20 teste	kite	3
120	CRM Nitrite	Material Referues i Çertifikuar për matjen e nitriteve, i përshtatshëm për Spectroquant Prove 300+, diapazon 0.002-1.0 mg/l. Madhësia 500 ml	shishe	2
121	CRM Amoniaku	Material Referues i Çertifikuar për matjen e amoniakut, i përshtatshëm për Spectroquant Prove 300+ diapazon 0.01-3.0 mg/l. Madhësia 500 ml	shishe	2
122	CRM Nitrate	Material Referues i Çertifikuar për matjen e nitrateve, i përshtatshëm për Spectroquant Prove 300+, diapazon 0.2-20 mg/l. Madhësia 500 ml	shishe	2
123	Solucion kontrolli	Check solution për photometers (445/446nm,520/525nm dhe 690nm). I përshtatshëm për Spectroquant Prove 300 +	set	2
124	Shishe qelqi	Madhësia 500 ml. Me kapak blu me material të pastër të përshtatshëm për laborator	shishe	100
125	Shishe qelqi	Madhësia 250 ml. Me kapak blu me material të pastër të përshtatshëm për laborator	shishe	50
126	E - coli	Terrene për matjen e e - coli së bashku me filtrat	copë	3000
127	Enterokoku	Terrene për matjen e enterokok së bashku me filtrat	copë	3000

Shënim:

Artikujt 1 dhe 3 janë pajisje aktuale në laboratorin e Impiantit dhe specifikimet teknike janë marrë nga manuali i këtyre pajisjeve. Pajisjet e reja duhet për shkak të daljes jashtë funksionit të pajisjeve ekzistuese.

Artikulli 2 është pajisje aktuale në laboratorin e Impiantit dhe specifikimet teknike janë marrë nga manuali i kësaj pajisje. Pajisja e reja duhet për shkak të shtimit të analizave.

Artikujt 4 është pajisje aktuale në Impiantin e Kavajës dhe Impiantin e Lalëzit. Specifikimet teknike janë marrë nga vet pajisja që ndodhen në këto impiante. Impianti i Durrësit nuk e disponon këtë pajisje.

Artikujt nga 1 deri në 33 i përkasin laboratorit të Impiantit të Durrësit.

Artikujt nga 34 deri në 54 i përkasin të dy laboratorëve.

Artikujt 55 deri në 127 i përkasin laboratorit të ujit të pijshëm.

Artikujt nga 7 deri 21, 29, 38 deri në 42, 47, 48, 55 deri në 65, 91 deri në 93, 104 deri në 123 si dhe artikujt 126 dhe 127 janë reagent/ materiale ndihmëse për kryerjen e analizave dhe **duhet që datat e skadencës të këtyre artikujve të jenë minimalisht 1 vit nga data e dorëzimit.**

Afati i levrimit të mallrave objekt prokurimi të jetë jo më vonë se 40 (dyzet) ditë nga dita e nënshkrimit të Planit të zbatimit të kontratës.